



## Projekti: Përforsimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

Shkup, 13.04.2017

Këshillimi i gjashtë dedikuar procedurës falimentuese, i mbajtur më 13 prill 2017 me temë „Kontestimi i veprimeve juridike të debitorit – aspektet normative dhe praktika gjyqësore,„ ngjalli interes të madh në mesin e ekspertëve. Mbi pesëdhjetë përfaqësues të Ministrisë së ekonomisë, administratorë falimentimi, gjykatës falimentimi dhe gjykatës që punojnë në lëndë që dalin nga procedura falimentuese, juristë dhe përfaqësues të institucioneve të tjera patën mundësinë që përveç legjislacionit, të diskutojnë edhe për kontestimin në praktikë, si dhe për dilemat dhe çështjet që imponohen nga rregullativa ligjore e cila në esencë është e mirë.

Nuk mund të flitet për kontestimin e veprimeve juridike e të mos përmendet kontestimi jashtëfalimentues, i definuar në Ligjin për marrëdhënie obligacioni, i cili mbulon pagimin e vetën një kreditori, gjë që është edhe dallimi thelbësor lidhur me kontestimin falimentues, ku duhet kushtuar vëmendje për pagesë të barabartë të të gjithë kreditorëve të cilët kanë paraqitur kërkesat e tyre. Mu për këtë qëndron edhe vlerësimi se instituti i kontestimit të veprimeve juridike është kompleks dhe kërkon qasje shumë më serioze nga ajo që haset në praktikë. Gjegjesisht, bëhet fjalë për një pjesë shumë të rëndësishme të Ligjit për falimentim, i cili mundëson parandalimin e diskriminimit apo favorizimin e kreditorëve të caktuar, me qëllim të mbrojtjes së masës falimentuese dhe pagesës së plotë dhe të barabartë të të gjithë kreditorëve falimentues. Mospërfillja trajtohet plotësisht njëjtë sikur edhe veprimi, respektivisht, si veprim juridik nënkuptohet edhe lëshimi i zbatimit të atyre veprimeve. Andaj, siç u theksua, janë hapur mundësi të panumërta për kontestim, e vetëm një segment prej tyre janë kontratat për cesione, ku shihet synimi i debitorit për shlyerjen e kërkesave të caktuara.



Që nga dispozitat e përgjithshme, me të cilat administratori falimentues në emër të debitorit falimentues dhe kreditorëve falimentues mund të kontestojë veprime juridike të ndërmarra para hapjes së procedurës falimentuese, me të cilat shkelet shlyerja e barabartë e kreditorëve, respektivisht disa prej kreditorëve vendosen në pozitë më të volitshme. U theksuan edhe rëndësia, roli dhe përgjegjësia e administratorit falimentues gjatë kontestimit të veprimeve juridike. Në fakt, në bazë të opinioneve në këtë këshillim, administratori falimentues ka rolin kryesor, me gjithçka që ndërmerr, ose nuk ndërmerr, dhe me pasojat që mund të dalin më pas. Rëndësi të madhe ka edhe mbledhja e tërë dokumentacionit, analizimi i mirë dhe rrënjësorë, që më pas të mund të harmonizohen veprimet e ndërmarra juridike.

I tërë procesi i kontestimit duhet të zhvillohet pandërprerë dhe në mënyrë të vazhdueshme, ku rolin kryesorë duhet ta ketë administratori falimentues – edhe pse edhe kreditori mund të kontestojë veprime juridike, por ai nuk i ka gjithmonë të gjitha të dhënat me të cilat disponon administratori falimentues.

Projekti „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare,“ realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian ndërsa zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.